



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 22 shkurt 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Vladimir Todoroviq, Armend Zemaj, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Arifaj – Asociacioni i Komunave të Kosovës, Albulena Ademi - NDI, Petrit Hysaj – OSBE, Shefki Kastrati – NDI, Driton Selmanaj – NDI, Vlora Marmullakaj - EULEX, Lumnije Murati - ZPRK, Lejla Selimi – OSBE dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Staf i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 shkurtit 2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare,
4. Shqyrtimi në parim i Projektkodit të Drejtësisë për të Mitur,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 shkurtit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15 shkurt 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazetën Zyrtare

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit dhe ata që monitoronin punën e Komisionit, në veçanti përfaqësuesen nga ambasada e Turqisë, znj. Sezi Anaq. Propozoi që shqyrtimi i Projektligjit, i cili në seancën e kaluar është miratuar në parim, meqë nuk është shumë vëllimor, propozoi të shqyrtohet nen për nen. Hapi debat lidhur me këtë pikë.

Adem Hajdari – Propozoi që të përkufizimet në nenin 2, në vend të fjalës “*nënkupton*” duhet të jetë “*është*”, sepse është krijuar një praktikë që të gjitha ligjet vijnë me këtë formulim.

Selvi Halimi - U pajtua me parafolësin rreth propozimit, por shtoi se nëse e ndërrojmë këtë fjalë, atëherë duhet edhe të modifikohet fjalia në tërësi, siç janë përkufizuar në nenin 2, paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5.

Adem Salihaj - Duke ju referuar nenit 2, paragrafi 1.2 tha se nuk definohet me një nen të veçantë në kuadër të kujt është zyra për Gazetën Zyrtare, por të përkufizimet thuhet se është në kuadër të zyrës së Kryeministrit. Kjo nuk është shumë parimore, ligjet që i miraton Kuvendi t'i shpall zyra e Kryeministrit. Do të duhej që kjo zyre të jetë në kuadër të Kuvendit. Në vazhdim kërkoi sqarim se a janë futur plotësimet në Projektligj, sepse kur është miratuar është thënë se miratohet me vërejtje Projektligji për Gazetën Zyrtare, prandaj është dashur të kthehet ky projektligj dhe të plotësohet me disa vërejtje.

Kryetari - Duke u ndërlidhur me parafolësin sqaroi se vërejtjet e dhëna janë inkorporuar në Projektligj. Ndërsa sa i përket zyrës kam takuar drejtorin e zyrës dhe ka qenë kërkesë që të kalojë në Kuvend. Mirëpo me këtë ligj ne nuk kemi mundësi ta kalojmë zyrën në Kuvend. Ne e kemi lënë, që ta bëjmë një kërkesë dhe të bisedojmë me Kryetarin e Kuvendit, në mënyrë që të marrë vendim të kalojë zyra në Kuvendin e Kosovës.

Ibrahim Makolli - Propozoi që fjalia: “*Që vepron në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës*” të hiqet, dhe të jetë vetëm: “**Zyra** “*nënkupton zyrën për publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës*”.

Në vazhdim iu referua nenit 5 të Projektligjit duke cekur se nëse nuk futen në këtë nen edhe komuniteti rom, atëherë po e shkelim kushtetutën. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut.

Adem Hajdaraj - Propozoi që nenin 5 të riformulohet: “*Të gjitha ligjet në Gazetën Zyrtare publikohen në gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe në gjuhët e tjera sipas Kushtetutës*”.

Muferra Şinik - Paraqiti Propozimamendamentet në emër të KDTP - së, të cilët propozuan që në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të bashkohen, ndërsa të fshihet 5.2., “*5.1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në gjuhën shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe angleze*”. Arsyetimin e mbështesin se Ligji

2004/47 për Gazetën Zyrtare të Kosovës, në pikën 3.1, thuhet “Gazeta Zyrtare e Kosovës do të botohet në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake”.

Kryetari - Propozoi që në neni 5 të thuhet: “*Të gjitha ligjet në Gazetën Zyrtare të publikohen në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe angleze*”, ndërsa me një paragraf të ri të themi: “*Mundësisht ligjet të publikohen edhe në gjuhën romë*”, sepse nuk ka kapacitet të gjitha ligjet të publikohen në të gjitha gjuhët.

Ibrahim Makoli - Në fjalën e tij të sërishme sqaroi se ligjet nuk bëhen vetëm për nivel lokal, por në përgjithësi për vendin, kjo sipas tij nuk është në pajtim me Kushtetutën, sepse ajo i përcakton qartë se cilat gjuhë përdoren në nivel qendror dhe lokal. Në vazhdim tha se Kosova nuk e besoj që nuk ka kapacitete që ligjet t’i botojë edhe në gjuhën romë, sepse ka romë të cilët e flasin edhe e shkruajnë gjuhën dhe nuk do të ishte problem që të angazhohen që t’i përkthejnë ligjet.

Adem Salihaj - U pajtua me parafolësin që të futet edhe gjuha romë duke shtuar se ata kanë televizione në gjuhën e tyre, ndërsa çështja e terminologjisë le të jetë çështje e tyre. Ne duhet t’i krijojmë kushtet ligjore, nëse ajo nuk mund të bëhet për shkaqe të tjera, të jepet arsytimi pse nuk mund të përdoret?

Kolë Berisha - Duke u ndërlidhur me parafolësit rreth propozimeve të bëra, tha se duhet të shikohet ligji për përdorimin e gjuhëve, sepse aty janë precizuar se cilat gjuhë janë në përdorim zyrtar.

Bajram Kosumi - E përkrahu parafolësin duke shtuar se këtë çështje duhet ta zgjedhim mbi parimet kushtetuese. Ishte i mendimet se duhet të futen të gjitha gjuhët, por duhet të shikojmë edhe ligjin për përdorimin e gjuhëve. Në vazhdim tha se në Kushtetutë janë të precizuara shumë qartë cilat gjuhë janë në përdorim zyrtar, qoftë në nivel lokal dhe në nivel qendror.

Selvije Halimi - Duke ju referuar nenit 5.1 të Projektligjit tha se ky nen i referohet vetëm publikimit të ligjeve, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni i referohet akteve të tjera, që mund t’i referohemi Kushtetutës, siç cekën parafolësit në nivel lokal. Në vazhdim shtoi se nëse i referohemi Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ky ligj i njeh dy gjuhë në nivel vendi, kurse gjuhët e tjera i njeh në nivel të komunave.

Armend Zemaj - Në fjalën e tij ceku se nëse nisemi nga qëllimi dhe fushëveprimi i këtij ligji që rregullon procedurat për publikimin në Gazetën Zyrtare, tha se nuk po e ndërrojmë Kushtetutën, por ligjin. Në vazhdim tha se në kushtetutë janë paraparë se cilat gjuhë janë në përdorim zyrtar, në dy nivelet në atë qendror dhe lokal. Për hir të informimit dhe duke marrë parasysh mentalitetin dhe shkollimin e komuniteteve që zhvillohet në Kosovë, konsideroi se ligjet duhet të publikohen në të gjitha gjuhët për Gazetën Zyrtare, sepse kjo i ndihmon integritet dhe demokracisë në vendin tonë.

Adem Hajdaraj - Në fjalën e tij të sërishme tha se nuk mundet të botohen ligjet në të gjitha gjuhët, sepse nuk ka mundësi teknike që të publikohen në të gjitha gjuhët. Ai ceku se gjuha romë nuk është gjuhë standarde.

Bajram Kosumi - Propozoi që në neni 5.1 të riformulohet si vijon: “*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës botohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhët në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës, sipas nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*”

Selvije Halimi – Lidhur me propozimin e KDTP - së tha se në këtë propozim kërkojnë që edhe t'i ndërrojnë vendet radhitja e gjuhëve, në vazhdim ceku se nenin 5.2, nëse e lëmë kështu si është, atëherë përveç ligjeve hynë edhe statutet e Komunave.

Kryetari - Duke folur për propozimin e KDTP - së, sqaroi se në neni 5.2, sponsorizuesi nuk i ka paraparë edhe aktet e tjera, siç janë p.sh. marrëveshjet ndërkombëtare që të publikohen në të gjitha gjuhët, sepse kjo ka implikime buxhetore.

Ibrahim Makolli - Tha se aktet nënligjore nuk shpallen në të gjitha gjuhët, ligjet mund të shpallen, por jo edhe aktet nënligjore.

Adem Salihaj - Propozoi që në nenin 10, paragrafi 1.4 të hiqet, sepse nuk guxon t'i bëhet lektorimi gjuhësor ligjit pas versionit përfundimtar.

Bajram Kosumi- U pajtua me parafolësin se redaktimi teknik që parashihet në nenin 10, paragrafi 1.3 e nënkupton përmirësimin e gabimeve teknike, ndërsa paragrafi 1.4 lektorimi nuk guxon të ketë ndërhyrje, prandaj duhet të hiqet.

Adem Hajdaraj - Tha se në nenin 11, paragrafi 1.3 bëri ndërhyrje gjuhësore, që në vend “*të lidh*” duhet të jetë “*të lidhë*”.

Armend Zemaj - Propozoi që në nenin 11, paragrafi 1.6 të hiqet, sepse në paragrafin 1.4 parashihen marrëveshjet që palët i përcaktojnë detyrimet reciproke.

Ibrahim Makolli - Propozoi që në nenin 12, paragrafi 1, lidhëza “*dhe*” para fjalës *rregullisht* dhe para fjalës *elektronike* të hiqet.

Adem Hajdaraj- Në nenin 15, paragrafi 2, bëri ndërhyrje gjuhësore që në vend “*të nxjerra*” duhet të jetë “*të nxjerrë*”.

Kryetari propozoi që neni 16, paragrafi 1 të hiqet, sepse nuk është vetëm zyra për publikimin e Gazetës Zyrtare përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Pas një diskutimi që u zhvillua, Komisioni vendosi që neni 5, paragrafi 1 dhe 2 i Projektligjit për Gazetën Zyrtare, mbetet të diskutohen edhe në një mbledhje të radhës.

Komisioni pas shqyrtimit të këtij neni do t'i votojë amendamentet e dala nga dy mbledhjet e Komisionit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektkodit të Drejtësisë për të Mitur

Komisioni e miratoi në parim Projektkodin e Drejtësisë për të Mitur dhe i njëjti procedohet për shqyrtim të mëtejme.

5. Të ndryshme

Kryetari paraqiti listën shtesë të ekspertëve për miratim, duke kërkuar që nëse ka propozime të tjera, që të jenë pjesë e kësaj liste, mund t'i paraqiten.

Bajram Kosumi - Propozoi që pjesë e kësaj liste të jetë edhe Blerim Buriani, **Ibrahim Makolli**, propozoi Besim Kelmendin, **Armend Zemaj**, propozoi kandidatet Xhevdet Halili dhe Osman Ismajli dhe **Adem Salihaj** propozoi Ekrem Shabanin.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni e miratoi listën shtesë të ekspertëve me plotësimet që pjesë e kësaj liste të jenë edhe propozimet e dala nga kjo mbledhje.

Komisioni u njoftua nga përfaqësuesi i OSBE - së rreth organizimit të një tryeze për Projektligjin për Avokatin e Popullit.

Kryetari i njoftoi se Komisioni në pjesën e parë të marsit do të mbajë dëgjim publik për Projektligjin, ekzekutimin e sanksioneve penale.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni